



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Tiranë, më 28.6.2018

Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9669, DATË 18.12.2006, “PËR MASAT NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”, TË NDRYSHUAR””

- Hyrje

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjet e datave 19, 20 dhe 26.06.2018 mori në shqyrtim projektligjin *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar”*”.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe specialistë të tjerë të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji është bazuar në nenin 78 dhe nenin 83 pika 1 të Kushtetutës. Nga analiza e nenit 81, pika 2 të Kushtetutës dhe përmbajtjes konkrete të këtij projektligji rezulton se fusha që rregullon ky projektligj nuk përfshihet në asnjë prej çështjeve që trajton dispozita kushtetuese, e për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj është konceptuar si një ndryshim i ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 *“Për disa masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, të ndryshuar, i cili tashmë me ndryshimet e sjella në Kodin Penal në vitet 2012 dhe 2013, me ratifikimin e Konventës së Stambollit, rekomandimet e dhëna në kuadër të Konventës *“Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”* CEDAW dhe procesit të integritimit evropian solli nevojën e hartimit të një ligji të ri¹.

Projektligji vjen në përputhje me rekomandimin kryesor të përfaqësuesve të nivelit të lartë të Bashkimit Evropian, siç parashtrohet edhe në dy raportet e takimeve të dialogut të nivelit të lartë Shqipëri – BE. Dialogu politik gjithëpërfshirës dhe transparent është i rëndësishëm për progresin e vendit në zhvillimin e reformave dhe konsolidimin e demokracisë si dhe në progresin integruar në Bashkimin Evropian. Ekzistenca dhe fuqizimi i shoqërisë civile është domosdoshmëri për një qeverisje demokratike dhe transparente. Projektligji është hartuar duke mbajtur parasysh parimet e shprehura në rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, *“Për procesin e integritimit evropian të Shqipërisë”* dhe *“Për njohjen dhe forcimin e rolit të shoqërisë civile në procesin e zhvillimeve demokratike të vendit”*.

Projektligji hartohet në përputhje me qëllimin strategjik 3 *“Zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”*, Objektivi 3.3.1 *“Përmirësimi i kuadrit ligjor në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje”* të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020 dhe Ratifikimit të Konventës së Stambollit dhe detyrimet që ajo sjell. Rekomandimet e dhëna në kuadër të Konventës *“Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”* CEDAW dhe procesi i integritimit evropian sollën nevojën e kryerjes së një analize të kuadrit ligjor në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje. Analiza mbi përputhshmërinë e legjislacionit të dhunës në familje me detyrimet ndërkombëtare u krye me kërkesë të ish-MMSR-së, me mbështetjen e PNUD-it, gjatë vitit 2014, rishikuar gjatë vitit 2016.

- Qëllimet kryesore që synon pr/ligji parashtrohen si më poshtë:
- ✓ parandalimin dhe reduktimin e rasteve të dhunës në familje;

¹Nga relacioni shoqërues del gjithashtu se për hartimin e projektligjit, grupi hartues është mbështetur nga ekspertë të UNDP me kërkesë të ish-MMSR gjatë viteve 2014 dhe 2016.

- ✓ rritjen e efikasitetit dhe bashkëpunimit të strukturave përgjegjëse që punojnë në mbështetje të viktimave të dhunës në familje;
- ✓ rritjen e pjesëmarrjes së dhunuesve në shërbimet specifike të rehabilitimit, me fokus të veçantë dhunuesit e alkoolizuar, të droguar ose me probleme të shëndetit mendor, të dhëna qartësisht në vendimet e gjykatave për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes;
- ✓ rritjen e mbështetjes së kualifikuar gjyqësore falas për viktimat e dhunës në familje.

Referuar nenit 2 të Projektligjit, parashikohet harmonizimi me nenin 3 të Konventës së Stambollit ku përkufizohet termi **“dhuna në familje”** e cila nënkupton *të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike, ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish-bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.*

Synohet të qartësohet dhe shtohet rrethi i subjekteve të mbrojtura në të cilën përfshihen personat që janë në lidhje afektive në çift, jo domodoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, si dhe mbrojtjen në raportet e zbatimit të institutit të kujdestarisë mbi të miturit dhe personat, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, sipas dispozitave të Kodit të Familjes. Gjithashtu sërish bazuar në Kodin e Familjes futet shtesa e termit “bashkëjetuesi”, i cili bëhet me qëllim barazinë e anëtarëve të krijuar nga martesë dhe nga bashkëjetesa.

Njëkohësisht synohet të përditësohen përkufizimet si *“njësi shtëpiake”*; *“urdhër paraparak i mbrojtjes së menjëhershme ose UPM”* dhe të unifikohen disa terma të tjerë me legjislacionin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

- Detyrat dhe përgjegjësitë për institucionet përgjegjëse

Detyrat kanë të bëjnë me edukimin e të miturve dhe të rinjve; rehabilitimin e të miturve dhunues; trajnimet detyruese dhe vazhduese të profesionistëve që merren me dhunën në familje; përgatitjen e psikologëve si pjesë e rëndësishme e procesit të rehabilitimit të viktimave të dhunës psikologjike etj. Më specifikisht parashikohet:

- ✓ ngritja e qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje;
- ✓ ngritja e strukturave trajnuese për dhunuesit;

- ✓ marrja e përgjegjësisë nga njësitë e qeverisjes vendore për mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të ligjit dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje;
- ✓ rregullimi i mënyrës së referimit të rasteve të dhunës në familje, monitorimi i ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes dhe të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes.

Neni 9 i projektligjit parashikon një masë të re mbrojtjeje urdhrin paraprak të mbrojtjes së menjëhershme (UPMM), i cili është reagimi i menjëhershëm për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje përmes një urdhri të arsyetuar e të lëshuar nga punonjësi i Policisë së Shtetit ose struktura e Policisë së Shtetit që trajton çështjet e dhunës në familje. Një masë e tillë duhet të verifikohet nga gjykata brenda afatit të përcaktuar në projekt, gjë që nuk e humb aspak karakterin e masave mbrojtëse që ka vetë ligji. Më specifikisht në ligj shprehet në këtë mënyrë:

Organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, kur vlerësojnë se, bazuar në fakte e rrethana të caktuara, dhuna që ushtrohet paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes, si dhe kur dhuna ushtrohet ndaj fëmijëve, marrin masa të menjëhershme për ndalimin e dhunës dhe, kryesisht, nxjerrin urdhrin paraprak të mbrojtjes së menjëhershme (UPMM), duke arsyetuar masat e marra.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision u vlerësua rëndësia dhe impakti që do këtë zbatimi i menjëhershëm i këtij projektligji në trajtimin e menjëhershëm dhe me efikasitet të viktimave të dhunës në familje në veçanti të grave të dhunuara, si dhe impaktin që do të ketë në marrjen e masave të menjëhershme në mbrojtjen e këtyre viktimave nga të gjithë institucionet e përfshira.

Nga ana e deputetëve u kërkuan sqarime në lidhje me një sërë çështjesh që nga mënyra se si do të ngrihen qendrat e emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje, në ngritjen e strukturave trajnuese për dhunuesit, eliminimin e çdo shpenzimi paraprak për personin e dhunuar, për masat për të siguruar gjykimin në një afat të shpejtë deri në konsultimin e projektligjit me grupet e interesi e më gjerë.

Në përgjigje të pyetjeve të ngritura nga deputetët e Komisionit, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale iu përgjigj pyetjeve dhe u shpreh se, projektligji ka për qëllim përqasjen dhe

harmonizimin më të mirë dhe brenda kontekstit të qëllimit e përmbajtjes së ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar me:

- ✓ Konventën e KE-së “Për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, ratifikuar me ligjin nr.104, datë 8.11.2012 dhe rekomandimet e Komitetit GREVIO, që vepron në kuadrin e kësaj konvente;
- ✓ Përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga Komiteti CEDAW në kuadër të raportimit për zbatimin e Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, në vitin 2016;
- ✓ Detyrimet që burojnë nga procesi i integritit evropian dhe me zgjidhjen e problemeve të evidentuara nga zbatimi i ligjit në praktikë, të shtuara, veçanërisht, gjatë kohëve të fundit.

Gjithashtu, Ministri sqaroi për deputetët e komisionit se objektivat e këtij projektligji janë parandalimi dhe reduktimi i rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare e në njësinë shtëpiake dhe mbrojtja e veçantë e pa diskriminim e çdo grupi që paraqet nevoja të veçanta mbrojtjeje, përmirësimi i masave mbrojtëse të parashikuara në ligj, në kuadrin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrit të mbrojtjes, duke pasur parasysh, sidomos, përmirësimin e masave mbrojtëse për fëmijët dhe të të gjitha subjekteve të mbrojtura, rritja e sigurisë që jep Policia e Shtetit nëpërmjet urdhrit paraprak të mbrojtjes së menjëhershme, rritja e ndihmës së kualifikuar gjyqësore falas përmes detyrave të parashikuara për Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Komisionin e Ndihmës Juridike, përcaktimi i afateve të qarta procedurale për regjistrimin e kërkesës për UM-në dhe UMM-në dhe për ankimet ndaj vendimeve gjyqësore e më gjërë.

Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë ka zhvilluar gjithashtu një seancë dëgjimore publike me Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri si dhe përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, të rrjetit të grave dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile.

IV. NDRYSHIMET NEN PËR NEN

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë gjatë shqyrtimit nen për nen të këtij projektligji i sugjeron komisionit përgjegjës këto ndryshime:

1. Në nenin 2, në pikën 2 të projektligjit, sugjerohet që togfjalëshi “autori i veprës penale” të zëvendësohet me termin “dhunuesi”.
2. Në nenin 2 propozohet që pika 2/d e projektligjit të ndryshohet si vijon “vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit, bashkëshortes, bashkëjetuesit/es”.
3. Në nenin 2, në pikën 2/ë u propozua si më poshtë:
 - a. Pas fjalës “të miturit” të shtohet togfjalëshi “kujdestarisë me pagesë për personat me aftësi të kufizuara”
4. Në nenin 5, pika h sugjerohet që pas fjalës “familje” të shtohet togfjalëshi “si dhe monitorimin e zbatimit të tyre”.
5. Në nenin 6 në pikën 1, të paragrafit c sugjerohet që pas fjalës “e nevojshme” të shtohet togfjalëshi “në përputhje edhe me parimin e “përshtatjes së arsyeshme”
6. Në nenin 6 në pikën 6 pas pikës ç propozohet të shtohet pika d) si vijon:
 - a. “Marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës”
7. Pas nenit 7 në nenin 7/1 sugjerohet të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
 - a. Kjo mbrojtje nënkupton asistencën për strehim të përkohshëm, transportin drejt një strehimi të sigurt apo drejt shërbimeve të kërkuara, shoqërimin drejt urgjencës apo shërbimeve mjekësore të domosdoshme ose pranë shërbimeve të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje etj.”
8. Në nenin 8 në pikën 3 në shkronjën “dh” propozohet që pas fjalës “rekomandon në një” të shtohet togfjalëshi me këtë përmbajtje:
 - a. Plan Personal të Ndërhyrjes masat dhe shërbimet e nevojshme që duhen marrë për të mbrojtur viktimën nga dhuna në vazhdimësi, ofrimin e shërbimeve të menjëhershme dhe minimizimin e pasojave të dhunës”.
9. Në nenin 10 në pikën “j” propozohet që pas fjalës “të miturin” të shtohet togfjalëshi “kujdestarinë me pagesë për personat me aftësi të kufizuara”
10. Në nenin 10 të projektligjit sugjerohet që në pikën 5 pas fjalës “paditësit/es të shtohet togfjalëshi “por në asnjë rast nuk mund të japë urdhra mbrojtje/urdhra të menjëhershëm mbrojtje për të dyja palët ndërgjyqëse njëkohësisht ose përgjatë zbatimit të urdhrit”.
11. Në nenin 13/1, në pikën 4 sugjerohet të shtohet fjalia “Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit dhe/ose koordinatori vendor paraqiten në seancën gjyqësore për të dhënë shpjegime”.

12. Në nenin 14, në pikën 4 të projektligjit propozohet që pas fjalës “psiko-social” të shtohet togfjalëshi “të interpretit të gjuhës së shenjave”.

V. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

ZV/KRYETARI

Elisa SPIROPALI